

STATISTIKA MBI NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

2024

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) vazhdojnë të kenë rolin kryesor në ekonominë shqiptare. Në vitin 2024, këto ndërmarrje zënë pjesën më të madhe të aktivitetit ekonomik në vend dhe kontribuojnë në pjesën më të madhe të punësimit.

Treguesit kryesorë

Në vitin 2024:

- 99,9 % e ndërmarrjeve aktive në ekonomi janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme.
- 82,0 % e të punësuarve në ekonomi punojnë në këto ndërmarrje.
- 81,4 % e shitjeve neto në ekonomi realizohen nga NVM.
- 75,0 % e investimeve në ekonomi kryhen nga këto ndërmarrje.
- 78,1 % e vlerës së shtuar në ekonomi realizohet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Krahasuar me vitin 2023, pesha e NVM-ve në ekonomi mbetet pothuajse e pandryshuar.

Krahasimi me Bashkimin Evropian

Treguesit kryesorë që karakterizojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri, krahasuar me Bashkimin Evropian, tregojnë se këto ndërmarrje kanë një peshë më të madhe në ekonominë shqiptare.

- 82,0 % e punësimit në Shqipëri gjenerohet nga NVM-të,
- 65,1 % e punësimit në Bashkimin Evropian gjenerohet nga NVM-të.

Gjithashtu, NVM-të në Shqipëri , krijojnë 78,1 % të vlerës së shtuar në ekonomi, ndërsa në BE kjo peshë është 53,6 %.

Ndërmarrjet eksportuese dhe importuese

Në vitin 2024:

- 3,1 % e NVM janë ndërmarrje eksportuese,
- 11,9 % janë ndërmarrje importuese.

Kjo tregon se shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme operojnë kryesisht në tregun e brendshëm.

Struktura sipas sektorëve

Mikrondërmarrjet kanë peshën më të madhe të punësimit në sektorin e akomodimit dhe shërbimit ushqimor.

Ndërmarrjet e vogla janë më të përqendruara në sektorin e ndërtimit, ndërsa ndërmarrjet e mesme kanë peshën më të madhe të punësimit në industrinë përpunuese.

Mikrondërmarrjet kanë përqindjen më të lartë të shitjeve neto në sektorin e Akomodimit dhe shërbimit ushqimor me 47,3 %. Ndërmarrjet e vogla kanë përqindjen më të lartë të shitjeve neto në sektorin e Tregtisë me 31,9 %. Ndërmarrjet e mesme kanë përqindjen më të lartë të shitjeve neto në sektorin e Industrisë përpunuese me 35,8 %.

Tab.1 Treguesit kryesorë dhe struktura e tyre sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2024


Madhësia e ndërmarrjes	Ndërmarrjet		Të punësuarit		Shitjet neto		Investimet		Vlera e Shtuar	
	nr.	%	nr.	%	mIn Lekë	%	mIn Lekë	%	mIn Lekë	%
Gjithsej	119.870	100,0	551.189	100,0	3.532.889	100,0	200.820	100,0	1.008.026	100,0
NVM (1-249 të punësuar)	119.696	99,9	451.981	82,0	2.876.914	81,4	150.684	75,0	787.261	78,1
Mikrondërmarrje (1-9 të punësuar)	112.411	93,8	208.422	37,8	919.721	26,0	43.181	21,5	286.210	28,4
Ndërmarrje të Vogla (10-49 të punësuar)	6.018	5,0	118.818	21,6	1.010.236	28,6	63.615	31,7	258.925	25,7
Ndërmarrje të Mesme (50-249 të punësuar)	1.267	1,1	124.741	22,6	946.957	26,8	43.888	21,8	242.126	24,0
Ndërmarrje të Mëdha (250+ të punësuar)	174	0,1	99.208	18,0	655.975	18,6	50.136	25,0	220.765	21,9

Tab.2 Struktura e treguesve kryesorë sipas madhësisë së ndërmarrjes në Shqipëri dhe BE, 2024

Madhësia e ndërmarrjes	Ndërmarrjet (%)		Të punësuarit (%)		Vlera Shtuar (%)	
	Shqipëri	BE*	Shqipëri	BE*	Shqipëri	BE*
Gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
NVM (1-249 të punësuar)	99,9	99,8	82,0	65,1	78,1	53,6
Mikrondërmarrje (1-9 të punësuar)	93,8	93,6	37,8	30,1	28,4	20,1
Ndërmarrje të Vogla (10-49 të punësuar)	5,0	5,4	21,6	19,5	25,7	16,6
Ndërmarrje të Mesme (50-249 të punësuar)	1,1	0,8	22,6	15,5	24,0	16,9
Ndërmarrje të Mëdha (250+ të punësuar)	0,1	0,2	18,0	34,9	21,9	46,4

* Burimi i të dhënave për BE-në: Annual Report European SMEs 2024/2025, <https://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/handle/JRC142263>

Fig.1 Struktura e shitjeve neto sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë së ndërmarrjes, 2024



Shënim për përdoruesit: Të dhënat e detajuara vjetore sipas aktiviteteve ekonomike janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Informacioni Ekonomik për Ndërmarrjet](#), si dhe në seksionin e tabelave në website në temën: [Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve Ekonomike](#)

Metodologjia

Ky publikim paraqet për përdoruesit, statistika mbi situatën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve dhe Tregtisë së Jashtme të Mallrave. Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve ka për qëllim të ofrojë informacion mbi strukturën ekonomike, financiare dhe karakteristikat kryesore të ndërmarrjeve aktive në vend sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë së ndërmarrjes.

Statistikat strukturore të ndërmarrjeve kanë si qëllim të tregojnë strukturën e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike nëpërmjet të dhënave bazë. Treguesit paraqiten për aktivitetet ekonomike gjithsej, sipas degëve dhe sipas madhësisë së ndërmarrjeve. Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet që prodhojnë të mira e shërbime në Shqipëri, për të gjitha format ligjore (nuk përfshihen aktivitetet e bujqësisë, peshkimit, aktivitetet e ndërmjetësimit monetar dhe financiar, administrata publike dhe e mbrojtjes si edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare). Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat sipas regjistrit statistikor janë aktive në dhjetor të vitit referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Viti fiskal korrespondon me vitin kalendarik. Për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë mostër me zgjedhje për anketim. Ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht. Grumbullimi i të dhënave është kryer me intervistim të drejtpërdrejtë pranë ndërmarrjeve.

Bazuar në ligjin Nr. 43/2022, "Për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme", ndërmarrjet klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme:

1. Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të) janë tërësia e ndërmarrjeve në të cilat punësohen më pak se 250 persona dhe realizojnë një shifër afarizmi ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë.
2. Ndërmarrje e vogël konsiderohet një ndërmarrje me më pak se 50 persona të punësuar, e cila ka një shifër afarizmi ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë.
3. Mikrondërmarrje konsiderohet një ndërmarrje me më pak se 10 persona të punësuar, e cila ka një shifër afarizmi ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë.

4. Ndërmarrje e mesme konsiderohet një ndërmarrje me 50 persona të punësuar deri në 249 persona të punësuar, e cila ka një shifër afarizmi ose një bilanc total vjetor nga 50 milionë lekë deri në 250 milionë lekë

Për qëllime statistikore, në këtë publikim, klasifikimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë është bërë vetëm sipas numrit mesatar të të punësuarve gjithsej, si më poshtë:

1. mikrondërmarrje: ndërmarrjet me 1 deri 9 të punësuar mesatar gjithsej;
2. ndërmarrje të vogla: ndërmarrjet me 10 deri 49 të punësuar mesatar gjithsej;
3. ndërmarrje të mesme: ndërmarrjet me 50 deri 249 të punësuar mesatar gjithsej.

Për më shumë informacion metodologjik mbi vërtetimin strukturor pranë ndërmarrjeve referohuni link-ut:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sherbimet/statistikat-strukture-të-ndërmarrjeve-ekonomike/#tab4>

Për më shumë informacion metodologjik mbi tregtinë e jashtme të mallrave referohuni link-ut:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/tregtia-e-jashtme/tregtia-e-jashtme-e-mallrave/#tab4>

Përkufizime të variablave

Ndërmarrja

Ndërmarrja është njësia më e vogël e kombinimit të njësisë ligjore me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Shitjet neto

Shitjet neto përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vërtetohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me vlerën e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar. Ky variabël mund të gjendet në botimet e tjera me termat: shifra e afarizmit ose xhiro.

Numri i të punësuarve

Numri i të punësuarve përfshin të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjesëtarët e familjes të papaguar.

Investimet

Investimet gjatë periudhës referuese përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera prej ndërmarrjeve ose të krijuara për llogari të vet me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se 1 vit në procesin e prodhimit, përfshirë tokën.

Vlera e shtuar

Vlera e shtuar me çmime bazë llogaritet si diferencë e vlerës së prodhimit me konsumin ndërmjetës.

Eksportet

Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, të përpunimit pasiv, të rieksporuara për t'ju nënshtruar përpunimit aktiv.

Importet

Janë në përgjithësi mallra që vijnë nga një vend i tretë dhe të vendosura direkt në magazinat e ruajtjes, nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.